



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 86 Prot

Maliq, më 31.07.2024

VENDIM

Nr. 77 , datë 31.07.2024

“Për miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së datës 31.07.2024 të Këshillit të Bashkisë Maliq”

Në zbatim të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 8, pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma “b”, neni 53 pika 3, neni 54 gërma “k” si dhe neni 66, pika 11 e Rregullores të funksionimit të Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, Këshilli i Bashkisë Maliq,

VENDOSI:

1.Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Maliq, të datës 31.07.2024 sipas njoftimit bashkangjitur.

2.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 3586 Prot.

Maliq, më 26.07.2024

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "*Për vetëqeverisjen vendore*" datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, "*Funksionimi i këshillit bashkiak*", pika 4 dhe 5, neni 56 "*Kryetari i këshillit bashkiak*" pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, "*Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq*" ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e **mërkurë, më datë 31.07.2024, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.06.2024.
4. P-V "Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin qershor 2024";
5. P-V "Për dhënien e ndihmës financiare për familje në nevojë, financuar nga projekti me Fondin Social";
6. P-V "Për rishpërndarjen e buxhetit të bashkisë Maliq për vitin 2024";
7. P-V "Për dhënien në përdorim të përkohshëm të fondit pyjor në pronësi dhe në administrim të Bashkisë Maliq për ndërtim linje elektrike Lenie-Maliq nga kompania Grabova 2";
8. Informacion lidhur me shqetësimin e fermerëve të bashkisë Maliq, për tregëtimin e produkteve bujqësore.
9. Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit janë si më poshtë:

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikëqyrjes Financiare. Pika 4, 5, 6 e rendit të ditës.
znj. Rudina Bregu, znj. Pranvera Begolli, z. Petrit Kupe, z. Andonag Risto, znj. Eglantina Balli.

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut. Pika 4, 5 e rendit të ditës.
znj. Nersida Shindo, znj. Gentiana Drabo, z. Armando Dautllari, z. Plator Çollaku, znj. Marjeta Xhelollari



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujrave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit. Pika 7 e rendit të ditës.

z.Fevri Sherifi, znj.Marianthi Avrami, znj.Rovena Terolli, znj.Albina Xhejo, z.Faslli Zholi

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMQELLARI

